

VENDIM
Nr. 58, datë 5.11.2019

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KOMISIONIT KOMBËTAR RREGULLATOR
NR. 22, DATË 30.3.2018, “PËR LICENCIMIN E SHA UJËSJELLËS-KANALIZIME
RROGOZHINË”

Në mbështetje të neneve 13, 14, 16 dhe 17, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar (ligji nr. 8102); VKM-së nr. 958, datë 6.5.2009, “Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licencë” (VKM nr. 958); si dhe vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 29, datë 8.12.2009, “Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar (Rregullore e licencimit),

Komisioni Kombëtar Rregullator,

në mbledhjen e datës 5.11.2019, pasi shqyrtoi çështjen me objekt: Mbi miratimin e projektvendimit “Për një ndryshim në vendimin e Komisionit Kombëtar nr. 22, datë 30.3.2018, ‘Për licencimin e sh.a. Ujësjiellës-Kanalizime Rrogozhinë’”,

VËREN SE:

1. Shoqëria Ujësjiellës-Kanalizime Rrogozhinë (UK Rrogozhinë), me shkresën nr. 76 prot., datë 6.10.2019, me lëndë: Njoftim në lidhje me ndryshimin e drejtuesit ligjor dhe drejtuesit teknik të sh.a. Ujësjiellës-Kanalizime Rrogozhinë, ka paraqitur pranë Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (ERRU), kërkesën për rinovim të licencës për efekt të ndryshimit të drejtuesit ligjor dhe të drejtuesit teknik, të shoqëruar me dokumentacionin sipas përcaktimeve të parashikuara në VKM-në nr. 958 dhe rregullores së licencimit.

2. Komisioni Kombëtar Rregullator (KKRR) e gjeti paraqitjen e kërkesës së UK Rrogozhinë për rinovim licence për efekt të ndryshimit të drejtuesit ligjor dhe të drejtuesit teknik në konformitet me kriteret dhe procedurën e parashikuar në VKM-në nr. 958 dhe rregulloren e licencimit.

3. KKRR-ja ka licencuar shoqërinë UK Rrogozhinë me vendimin nr. 22, datë 30.3.2018, “Për licencimin e sh.a. Ujësjiellës-Kanalizime Rrogozhinë”, me një afat 4-vjeçar, ku shoqëria autorizohet të ofrojë shërbimin e grumbullimit dhe të shpërndarjes së ujit për konsum publik, si dhe të largimit të ujërave të ndotura.

4. Drejtuesi ligjor i shoqërisë UK Rrogozhinë sh.a., z. Skënder Dedej, ka mbaruar studimet e larta në Inxhinieri mekanike në vitin 1996, ka shërbyer edhe më parë si drejtues ligjor i kësaj shoqërie nga viti 1990–1991 dhe nga viti 1998–2006.

5. ERRU-ja, në vlerësimin e kërkesës për ndryshimin e licencës për efekt të ndryshimit të drejtuesit ligjor dhe të drejtuesit teknik, ka marrë në konsideratë përmbushjen nga ana e UK Rrogozhinë sh.a. të kërkesave të ligjit nr. 8102, të VKM-së nr. 958 dhe të rregullores së licencimit, në mënyrë të veçantë, sa i takon garantimit që i licencuari të veprojë në përputhje me kushtet e licencës së tij dhe të mbrojë interesat e konsumatorëve në lidhje me cilësinë, eficiencën, vazhdueshmërinë dhe garancinë e shërbimit.

Për gjithë sa më sipër, Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi arriti në përfundimin se aplikimi i UK Rrogozhinë është i bazuar ligjërisht dhe plotëson kërkesat ligjore të parashikuara në kuadrin rregullator në fuqi,

VENDOSI:

Në pikën 1 të vendimit të KKRR-së nr. 22, datë 30.3.2018, “Për licencimin e sh.a. Ujësjiellës-Kanalizime Rrogozhinë”, bëhen këto ndryshime:

“Drejtues ligjor: Skënder Dedej;

Drejtues teknik: Skënder Dedej.”

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Ndriçim Shani